



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 2795 Dt. 11 / 12 / 2023

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e VI të mbajtur më datë 01.12.2023, mori këtë:

VENDIM

Ligjëruese Dr.sc. Afërdita Ibrahimimi zgjidhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët nga fusha kompjuterike në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 172 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/742 të datës 28.04.2022.

E përmendura është e obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurës i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/1637 të dt.13.09.2023, sipas Rregullores për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për lëndët: (Databaza (O), Siguria e kualitetit të softurëve (Z), Vizualizimi dhe procesimi i imazheve (O), Analiza e kërkesave për Webaplikacione (Z); Siguria e rrjetave (O), Data science (O).

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që ligjëruesja Dr.sc. Afërdita Ibrahimimi, i plotëson kushtet ligjore për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/2592 të datës 30.11.2023, vendosi që ligjëruese Dr.sc. Afërdita Ibrahimimi të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurës
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave

Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor
Kryesues i Senatit

